

PRANIMI NË SPITAL I PERSONIT ME ÇRREGULLIME MENDORE I GJETUR NË VEND PUBLIK

(Paragrafi 136 i Aktit për Shëndetin Mendor 1983)

1. Emri i pacientit	
2. Emri i spitalit dhe pavijonit	

Përse jam në spital?

Ju jeni sjellur këtu nga një polic sepse ata shqetsohen se mos keni çrregullim mendor dhe duhet vizitoheni nga një person professional për shëndetin mendor.

Ju mbaheni sipas paragrafit 136 të Aktit për Shëndetin Mendor 1983 në mënyrë që të kontrolloheni për t'ju caktuar mjekimin e duhur.

Sa kohë do të qëndroj këtu?

Ju mund të mbaheni aty (ose në një vend tjetër ku do të jeni të sigurtë) deri në 72 në mënyrë që të vizitoheni nga një mjek dhe një person professional i aprovuar për shëndetin mendor.

Personi profesional i aprovuar për shëndetin mendor është një person i trajnuar posaçërisht për të ndihmuar të vendos nëse njerëzit kanë nevojë të mbahen në spital.

Nëse mjeku dhe personi profesional i aprovuar për shëndetin mendor pajtohen se ju keni nevojë të qëndroni në spital, një mjek i dytë duhet të ftohet për të konfirmuar vendimin e tyre.

Gjatë kësaj kohe ju nuk duhet të dilni nga spitalin, përveç nëse ju thonjë se mund të dilni. Nëse provoni të dilni nga spitali stafi mund t'ju ndaloj, dhe nëse dilni ata mund t'ju kthejnë mbrapsht.

Nëse pas 72 orëve nuk ju kanë thënë se ju duhet të qëndroni në spital, ju jeni të lirë të dilni nga spitali. Por, ju mund të vendosni të qëndroni në spital si pacient vullnetar. Nëse nuk

dëshironi të dilni nga spitali pas përfundimit të 72 orëve, ju lutem së pari bisedoni me një anëtar të stafit.

Në rastin tuaj 72 orët përfundojnë me:

Data	Koha
------	------

Çfarë ndodhë më tutje?

Pasi t'ju vizitojnë mjekët dhe personi profesional i aprovuar për shëndetin mendor, ata mund t'ju thonë se ju keni nevojë të qëndroni më gjatë në spital. Ata do t'ju tregoj pse dhe për sa kohë mund të qëndroni në spital. Juve do t'ju jepin edhe një fletëpalosje tjetër për t'ju treguar se çfarë do të ndodhë.

Nëse vendoset se ju nuk keni nevojë të qëndroni në spital, ata (ose një anëtar tjetër i stafit) do të bisedoj me ju se çfarë ndihme tjetër duhet të merrni.

A mund të apeloj?

Jo. Edhe pse ju nuk jeni dakord se tani duhet të qëndroni në spital, ju nuk mund të apelonit kundër vendimit për t'ju mbajtur këtu, sipas paragrafit 136.

A do t'më ofrohet mjekim?

Stafi i spitalit do t'ju tregoj lidhur me ndonjë mjekim që mendojnë se keni nevojë. Ju keni të drejtë të refuzoni mjekimin që nuk e dëshironi. Vetëm në rrethana të veçanta, të cilat do t'ju shpjegohen, mund t'ju jepet mjekim pa pajtimin tuaj.

Njoftimi i anëtarit më të afërm familjar

Një kopje e kësaj fletëpalosje do ti jepet një personi të cilin Akti i Shëndetit Mendor e konsideron si më të afërmin e familjes tuaj.

Është një listë e njerëzve në Aktin e Shëndetit Mendor që konsiderohen si anëtar të familjes suaj. Zakonisht, personi që është në krye të listës është anëtari më i afërt familjar. autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë dhe se çfarë të drejtash ka me i afërmi familjar tuaj në lidhje me kujdesin dhe mjekimin.

Ne jemi njoftuar se në rastin tuaj, anëtari më i afërt familjar është:

Nëse ju nuk dëshironi që ky person të marrë një kopje të fletëpalosjes, ju lutem tregoni infermierit tuaj ose një anëtar të stafit.

Ndërrimi i anëtarit më të afërm familjar

Nëse mendon se ky person nuk është i përshtatshëm të konsiderohet më i afërmi i familjes tuaj, ju mund të aplikoni tek Gjykata e Qarkut për të konsideruar një person tjetër si më të afërmin tuaj familjar. Autoriteti i shërbimeve sociale mund t'ju jep një fletëpalosje e cila e shpjegon këtë.

Letrat e juaja

Të gjitha letrat e marruara gjatë qëndrimit tuaj në spital do t'ju dorzohen juve. Ju mund t'ju dërgoni letër çdonjërit, përveç ndonjërit që ka pohuar se nuk dëshiron të marrë letra nga ju. Letrat dërguar këtyre personave mund të ndalohen nga stafi i spitalit.

Kodi Praktik

Kodi Praktik është ai që jep këshilla lidhur me Aktin e Shëndetit Mendor njerëzve të përfshirë në kujdesin tuaj. Ata duhet të marrin parasysh se çfarë thotë Kodi kur të marrin vendim lidhur me kujdesin tuaj. Nëse doni , ju mund të kërkonit të shihni një kopje të Kodit.

Si të ankohem?

Nëse doni të ankoheni lidhur me ndonjë pakënaqësi që ka të bëjë me kujdesin dhe mjekimin tuaj në spital, ju lutem bisedoni me një anëtar të stafit. Ata mund të rregullojnë këtë çështje. Ata poashtu mund t'ju jepen informacion lidhur me procedurën e ankimit të spitalit, të cilën mund të përdorni për të zgjidhur pakënaqësinë tuaj nëpërmjet të quajturit vendim lokal. Ata poashtu mund t'ju tregojnë për persona të tjerë që mund t'ju ndihmojnë për t'u ankuar.

Nëse mendoni se procedura e ankimit nuk mund t'ju ndihmon, ju mund të ankoheni tek një Komision i pavarur. Komisioni i pavarur e monitoron mënyrën e zbatimit të Aktit të Shëndetit Mendor, për të siguruar përdorim të drejtë dhe kujdes të duhur ndaj pacientëve gjatë qëndrimit të tyre në spital. Stafi i spitalit mund t'ju jep një fletëpalosje e cila shpjegon se si të kontaktoni me Komisionin.

Ndihmë dhe informacion të mëtejshëm

Nëse ka diçka që nuk kuptoni lidhur me kujdesin dhe mjekimin, një anëtar i stafit do të përpiqet t'ju ndihmoj. Ju lutem kërkoni nga një anëtar t'ju shpjegoj nëse ka diçka në këtë fletëpalosje që nuk kuptoni, ose nëse keni ndonjë pyetje tjetër që nuk iu ka përgjegjur fletëpalosja.

Ju lutem kërkoni një kopje të kësaj fletëpalosje nëse i duhet edhe dikujt tjetër.